



**UDHËZUES PRAKTIK PËR MBROJTJEN DHE RUAJTJEN
E BANESAVE TRADICIONALE
NË FSHATRAT E BREGDETIT TË HIMARËS
SHTOJCA**



4. Shtojcat

Ky libërth që shoqëron udhëzuesin përfshin informacione të dobishme për ligjet, vendimet dhe rregulloret në fuqi në Republikën e Shqipërisë që lidhen me çështjet në fokus të këtij udhëzuesi shoqëruar me përshkrime të detajuara të terminologjisë së trashëgimisë kulturore.

Këtu përfshihen: rregulloret mbi qendrat historike dhe harta të detajuara të tyre; informacion mbi mënyrat e aplikimit për leje si dhe një listë e dokumenteve që nevojiten për të marrë leje në institucionet e trashëgimisë kulturore dhe bashki; një listë emërore e arkitektëve me licensë në punë restauratore; dhe kontakte të institucioneve ku mund të gjeni më shumë informacion.

Ky dokument u hartua në korrik 2018. Çdo informacion i përfshirë këtu mund të jetë subjekt i ndryshimeve si pasojë e natyrës dhe burimeve të informacionit.

Përmbajtja e shtojcave:

- 4.1 Shtojca A: Ligje dhe rregullore
- 4.2 Shtojca B: Terminologjia në ligj
- 4.3 Shtojca C: Qendrat historike
- 4.4 Shtojca D: Si të marrësh leje
- 4.5 Shtojca E: Kontakte të dobishme



4.1 Ligje dhe rregullore

Vendbanimet tradicionale të Bashkisë Himarë kanë vlera domethënëse historike e kulturore. Këto vendbanime duhen ruajtur dhe zhvilluar në mënyrë të qëndrueshme. Për këtë arsye, janë miratuar disa ligje dhe vendime për mbrojtjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të këtyre pasurive tepër të rëndësishme. Këto dokumente janë baza e politikave rregullatore për zhvillimin e territorit në këto zona. Ato përcaktojnë ndërhyrjet e lejuara si dhe kushtet për zhvillim. Disa prej këtyra zonave kanë rregullore më specifike krahasuar me të tjerat në varësi të nivelit të rëndësisë dhe statusit të tyre.

Këto ligje apo rregullore janë:

1. Ligje të trashëgimisë kulturore:

- Ligji nr. 90 48, dt. 07.04.2003 "Per trashëgimine kulturore", i ndryshuar
- Ligji nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë."

2. Vendime të Këshillit të Ministrave (VKM) për shpalljen e Qendrave Historike

Që prej janarit të vitit 2016, katër fshatra të Bashkisë Himarë janë shpallur Qendra Historike. Këto fshatra janë: Himarë Fshat, Dhërmi, Vuno dhe Qeparo. Si qendra historike, në këto zona zhvillimet e reja apo ndërhyrjet duhet të ndjekin disa rregulla të përcaktuara rigorozisht.

- VKM nr.28, datë 20.01.2016 "Për shpalljen e qendrës historike të qytetit të Himarës dhe miratimin e rregullores për administrimin e saj e të zonës së mbrojtur përreth".
- VKM nr. 29, datë 20.1.2016 "Për shpalljen e qendrës historike të fshatit Dhërmi dhe miratimin e rregullores për administrimin e saj e të zonës së mbrojtur përreth".
- VKM nr.30, datë 20.01.2016 "Për shpalljen e qendrës historike të fshatit Vuno dhe miratimin e rregullores për administrimin e saj e të zonës së mbrojtur përreth".
- VKM nr.636, date 7.9.2016 "Për shpalljen e qendrës historike të fshatit Qeparo dhe miratimin e rregullores për administrimin e saj e të zonës së mbrojtur përreth".

3. Plani i Përgjithshëm Vendor i Himarës

I miratuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit më 16.10.2017, vendimi nr.02

Këto ligje parashikojnë rregulla dhe politika zhvillimi të cilat duhen ndjekur në këto zona. Zhvillimet dhe ndërtimet e reja janë më të kufizuara në disa zona, në varësi të statusit të tyre të mbrojtjes.

Kategoritë e statusit të mbrojtjes:

- 1** Monumentet e kategorisë së parë ose të dytë.
- 2** Qendrat historike (Dhërmi, Vuno, Himara, Qeparo), brenda qendrës historike apo zonës së mbrojtur përreth saj.
- 3** Një ndërtesë, e cila nuk ka status mbrojtjeje si trashëgimi kulturore (nuk renditet në asnjë nga kategoritë më sipër) por është pjesë e vendbanimeve tradicionale.

Për më shumë detaje mbi atë çka këto vendime/ rregullatore/ parashikojnë dhe hartat e detajuara të qendrave historike, shih faqet 4-9.

4.2 Terminologjia në ligj

1. Fragmente nga ligji nr. 27/2018
"Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë."

2. Fragmente nga vendimet e Këshillit të Ministrave "Për shpalljen e qendrave historike të Himarës, Dhërmiut, Vunoit e Qeparoit".

1 Çfarë është një monument kulture?

"Monument kulture" është objekti ose ndërtimi me vlera historiko-kulturore, që mbrohet nga shteti¹.

Ndarja e monumenteve sipas kategorive

■ **"Monument kulture i kategorisë I"** është ndërtimi me vlera të spikatura dhe me rëndësi të veçantë për trashëgiminë kulturore, i cili ruhet në tërësinë e përbërësve të tij arkitektonikë dhe teknikë. Kompozimi i vëllimeve, trajtimi arkitektonik i pamjeve të jashtme e të brendshme, si dhe zgjidhja planimetrike e funksionale e këtyre monumenteve nuk mund të ndryshohen¹.

1. Trajtimi arkitektonik dhe kompozicional nuk mund të ndryshohet

2. Trajtimi arkitektonik i elementëve të jashtëm dhe zgjidhjet planimetrike të brendshme nuk mund të ndryshohen.

3. Teknikat e ndërtimit dhe materialet e përdorura nuk mund të ndryshohen

4. Oborri, muret rrethuese, porta e jashtme dhe ndërtimet ndihmëse janë pjesë organike e monumentit dhe, si të tilla, i nënshtrohen të njëjtit trajtim.

5. Në rastet kur një pjesë e monumentit ka pësuar dëmtime, transformime ose mungon, mund të ndërmerren ndërhyrje plotësuese sipas gjendjes fillestare.

6. Për monumentet jashtë qendrave historike, nuk lejohet ndërtimi i strukturave të reja në kufijtë e monumenteve të kulturës.

7. Trajtimi i objekteve ekzistuese kufitare të shqyrtohet në Këshillin Kombëtar të Restaurimeve, rast pas rasti².

■ "Monument kulture i kategorisë II"

1. Monumentet e kategorisë II janë ndërtime me vlera historiko-kulturore, kryesisht si formuese të ansambleve urbanistiko arkitekturore, marrin pjesë në formulimin kompozicional të fshatit, por dhe ruajnë vlera arkitekturore në vetvete.

2. Monumentet e kategorisë II ruhen në volumet e tyre fillestare dhe trajtimin e tyre arkitekturor të pamjes së jashtme, dhe të brendshme në raste të veçanta, kur brenda këtyre monumenteve, sidomos në objektet e banimit, ruhen ambiente karakteristike, si: gdhendje në dru, punime në allçi, dekorime pikturale ose mobilje arkitektonike me vlerë.

3. Në brendësi të monumenteve të kategorisë II lejohen ndryshime të strukturës kompozicionale dhe përdorimin e teknikave bashkëkohore, pa cënuar formulimin e pamjes së jashtme, si dhe për t'u adaptuar edhe për shërbime të tjera².

2 Çfarë është një qendër historike?

"Qendër historike" është territor i dallueshëm urban, përfaqësuese e një periudhe historike ose një faze të zhvillimit të qytetit/fshatit, që përbëhet nga elemente të trashëgimisë kulturore materiale, ku përfshihen, përveç strukturës urbane, elemente arkitektonike, mjedisore, kulturore, historike, peizazhe, brenda dhe rreth zonës, dëshmitë arkeologjike, panoramat, profilet urbane, perspektivat dhe pikat e referencës.

Qendrat historike janë objekte me vlera kulturore dhe historike, e si të tilla, ato mbrohen me ligj. Çdo ndërhyrje në qendrat historike duhet të ndjekë rregullat e parashikuara në vendimet e Këshillit të Ministrave e duhet miratuar nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve¹.

3 Çfarë është një zonë mbrojtëse?


"Zonë mbrojtëse" është një territor i përcaktuar me kufij të qartë, jashtë qendrës historike, ansamblit arkitektonik/urban, kompleksit arkitektonik dhe monumentit të kulturës, roli i së cilës është mbrojtja e vlerave të këtyre pasurive kulturore dhe sigurimi i dritës, perspektivës, peizazhit kulturor, shikimit, shijimit dhe përdorimit nga publiku¹.



4.3 Qendrat historike

Himarë fshat


Qendra historike e qytetit të Himarës kufizohet nga jugu, perëndimi dhe veriu nga konturi i mureve rrethuese të kalasë së Himarës dhe është hapësira me vlera të rëndësishme historike e arkitekturore, që dokumenton rrugën e zhvillimit të vendbanimit nga lashtësia e deri në ditët e sotme. Ajo përmban monumente antike, siç është kalaja e Himarës, fillimet e së cilës datojnë në shek. IV-III p.e.s., monumente kulti, siç është kisha e Shën Sergut dhe Bahut, fillimet e së cilës duhet t'i përkasin qendrës peshkopale të Himarës, shumë kisha të tjera pasbizantine, si dhe një numër të madh banesash me një tipologji të larmishme e një rrjet rrugor të kalldrëmuar, herë-herë me shkallëzime në pjerrësitë e terrenit dhe vende-vende me kalime në formë tuneli nën banesat e fshatit. Kufijtë e qendrës historike të qytetit të Himarës paraqiten në hartën e zonifikimit të qendrës historike si në figurën më poshtë².



Dhërmi

Qendra historike është pjesa më me vlera urbanistiko-arkitektonike e fshatit Dhërmi. Ajo ruan gjini të ndryshme ndërtimore, si ndërtime shoqërore, kulti dhe banesa popullore. Këto ndërtime janë të lidhura me peizazhin urbanistiko arkitektonik, historik tradicional, i cili është pjesë e qendrës historike. Qendra Historike përbëhet edhe nga zonat e gjelbra të përfshira brenda saj. Qendra Historike e fshatit Dhërmi përbëhet nga dy zona:

- Zona I, e cila përfshin ndërtimet në të dyja krahët e rrugës kombëtare në hyrje të fshatit Dhërmi;
- Zona II, e cila përfshin pjesën e Dhërmiut të vjetër dhe shtrihet në pjesën verilindore deri mbi rrënojat e manastirit të Panaisë me kishën e Fjetjes së Shën Mërisë dhe në jugperëndim zbret deri poshtë rrugës kombëtare².






4.3 Qendrat historike

Vuno

Qendra historike e fshatit Vuno përbëhet nga dy zona:

- Zona I, e cila përfshin ndërtimet në të dyja krahët e rrugës kombëtare (kryesisht Vunoi i vjetër);
- Zona II, e cila përfshin pjesën që ndodhet poshtë rrugës kombëtare, që përbëhet nga kompleksi i Kishës së Shën Spiridhonit së bashku me shkollën dhe Kishën e Shën Mëhillit. Në këto zona përfshihen një numër i konsiderueshëm banesash me një tipologji të larmishme dhe një rrjet rrugor të shtruar me kalldrëm, herë-herë të formuluar me shkallëzime në pjerrësitë e terrenit dhe vende-vende me kalime në formë tuneli nën banesat e fshatit².




 Monument kulture	 Qendër historike
 Ndërtesa	 Zonë e mbrojtur Nënkatëgoria 1

0 100 200 300 (m)

Qeparo

Qendra historike është pjesa më me vlera urbanistiko-arkitektonike e fshatit Qeparo (fshati i vjetër). Ajo ruan gjini të ndryshme ndërtimore, si: ndërtime shoqërore, kulti dhe banesa popullore. Këto ndërtime janë të lidhura me peizazhin urbanistiko-arkitektonik historik tradicional, i cili është pjesë e qendrës historike. Qendra historike përbëhet edhe nga zonat e gjelbra të përfshira brenda saj. Qendra Historike e fshatit Qeparo (fshati i vjetër) përfshin të gjitha ndërtimet ekzistuese dhe përbëhet nga një kompozim kompakt tradicional, që zhvillohet rreth kishës dhe sheshit qendror. Ansambli i ndërtuar paraqet tipologji interesante, si dhe përfshin një numër të konsiderueshëm banesash me një tipologji të larmishme, midis të cilave edhe një banesë monument kulture kategori I (banesa e Minella Gjikes) dhe një rrjet rrugor të shtruar me kalldrëm, herë-herë të formuluar me shkallëzime në pjerrësitë e terrenit dhe vende-vende me kalime në formë tuneli nën banesat e fshatit. Ndërtimet në përgjithësi janë dy-katëshe dhe janë ndërtuar me mur guri².





4.3 Qendrat historike

Ndërhyrjet e lejuara në qendrat historike:

- Ndërhyrjet restauruese dhe rigjallëruese që do të bëhen në qendrën historike, apo në monumentet e të dyja kategorive do të kenë si qëllim kthimin e fshatit në një qendër të rëndësishme turistike të karakterit rural e familjar. Për të realizuar këtë qëllim, për qendrën Historike kryhen studime për mënyrën e ndërhyrjeve restauruese dhe rigjallëruese në ndërtimet që e përbëjnë, si dhe për rehabilitimin e zonave të veçanta të saj.

Me qëllim ruajtjen e vlerave urbanistiko arkitekturore të qendrës historike të fshatit, brenda kësaj zone lejohen vetëm këto ndërhyrje:

- Ndërhyrjet sistematike konservuese, restauruese dhe të mirëmbajtjes në qendrën historike, si dhe në monumentet e të dyja kategorive mbështeten në kriteret për konservimin dhe restaurimin, të saktësuara në aktet normative kombëtare dhe ndërkombëtare të fushës, të zbatueshme edhe në vendin tonë.
- Ndërhyrjet restauruese synojnë ruajtjen e hapësirave urbanistiko-arkitekturore, rrjetit rrugor tradicional në kompozim dhe teknikë, si dhe mbajnë të pandryshuar konfiguracionin e truallit të hapësirave pushuese e të bimësisë tradicionale.
- Studime për rehabilitimin e pjesëve të veçanta të saj lidhur me qëndrimin ndaj ndërtimeve, që me volumet dhe formulimin e tyre arkitekturor dëmtojnë vlerat dhe unitetin kompozicional të qendrës historike.
- Studimet përcaktojnë objektet ku kryhen punime konservuese dhe restauruese, objektet ku kryhen ritrajtime për të rritur vlerat e tyre, objektet në gjendje rrënoje ose të papërshtatshme për funksionim dhe që cenojnë unitetin arkitekturor të ansamblit ose zonës, ku lejohet të kryhen rikonstruksione, zonat ku lejohet të kryhen ndërhyrje integruese, si dhe parcelat e gjelbëruara.
- Ndërhyrjet rehabilituese në shumë ndërtime në gjendje rrënoje konservuese ose restaurimet integruese për të penguar degradimin e mëtejshëm të tyre. Kur rrënojat ruhen dhe paraqesin vlera me rëndësi arkitektonike, kompozicionale dhe tipologji të veçanta, por cenojnë dukshëm njësinë e ansambleve, brenda të cilave përfshihen, mund të kryhet rikonstruksioni në të njëjtin vëllim mbi strukturën ekzistuese (mureve perimetrale) me objektiv primar ruajtjen sa të jetë e mundur të karakteristikave origjinale të dukshme, të jashtme dhe të brendshme, bazuar në dokumentacionin e qartë fotografik, grafik, mbështetur në tipologjinë, trajtimin arkitektonik dhe teknikën tradicionale të ndërtimit. Në rastet kur rrënojat janë nën 3 m, ato duhet të konsolidohen dhe, në raste të veçanta, mund të ringrihen, duke zbatuar parimet e mësipërme. Projektet për ndërhyrjet në këto lloj objektesh do të shqyrtohen dhe do të miratohen rast pas rasti në Këshillin Shkencor dhe Këshillin Kombëtar të Restaurimeve.
- Në rastet e fatkeqësive natyrore, të shembjeve ose djegies së objekteve me vlera të trashëgimisë kulturore, rikonstruksioni mund të kryhet mbi strukturat ekzistuese, sipas formulimit kompozicional dhe arkitektonik të gjendjes para rrënimit, bazuar në dokumentacionin e qartë fotografik, grafik etj.
- Në qendrën historike ndalohen ndërtimet e reja me përjashtim të rikonstruksionit të rrjetit inxhinierik nëntokësor dhe rikonstruksioneve të përmendura dhe më sipër.
- Projektet për përshtatjet, rikonstruksionet apo dhe ndërtimet e reja miratohen nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve².

2. Fragmente nga vendimet e Këshillit të Ministrave "Për shpalljen e qendrave historike të fshatrave Vuno, Himarë, Dhërmi dhe Qeparo."

2. Fragmente nga vendimet e Këshillit të Ministrave "Për shpalljen e qendrave historike të fshatrave Vuno, Himarë, Dhërmi dhe Qeparo."

Zona e mbrojtur dhe kufijtë e saj

Në fshatrat Himarë, Dhërmi dhe Qeparo, zona e mbrojtur përbëhet nga:

- Nënzona e mbrojtur 1
- Nënzona e mbrojtur 2

Nënzona I e mbrojtur përmban banesa me vlera arkitektonike dhe rrjetin rrugor karakteristik të fshatit, me të cilat plotësohen vlerat e Qendrës Historike.

Nënzona II e mbrojtur është një zonë me një gjelbërim që formohet nga drurë të ndryshëm, si me ullinj, rrepër dhe bimësi të ndryshme².

Në fshatin Vuno, zona e mbrojtur nuk ka zonë të gjelbër brenda saj.

Ndërhyrjet e lejuara në Zonën e mbrojtur

▪ Ndërhyrjet e rikonstruksionit në rrjetin rrugor dhe sheshe ruajnë detyrimisht materialet dhe teknikat tradicionale. Nuk lejohen ndryshimet në rrjetin rrugor ekzistues përveç rikonstruksionit të tij.

▪ Kryhen restaurime, përshtatje, rikonstruksione apo dhe ndërtime të reja për të rritur vlerat brenda saj dhe përmirësimin e kushteve të jetesës, të cilat duhet të jenë në harmoni me karakterin arkitektonik e urbanistik të ansamblit.

▪ Ruajtja e rrjetit rrugor në kompozimin dhe formulimin e tij urbanistiko-arkitektonik.

▪ Ruajtja dhe përfshirja e vlerave mjedisore duke mbajtur të pandryshuar konfiguracionin e truallit dhe llojshmërinë e drurëve e të bimësisë tradicionale.

▪ Lartësia maksimale ose numri i kateve duhet të jetë i njëjtë me mesataren e kateve të ndërtesave përreth, por sidoqoftë jo më shumë se 2 (dy) – 6.5 m deri në kornizën e çatisë, lartësi maksimale e marrë në pjesën me pjerrësi më të madhe të terrenit.

▪ Kompozimi arkitektonik i ndërtesave duhet t'i përshtatet karakterit arkitektonik e dekorativ të arkitekturës tradicionale, duke përdorur stilizime të elementeve morfologjike të saj, të kompozimeve vëllimore, ngjyrave etj.

▪ Projektet për përshtatjet, rikonstruksionet apo dhe ndërtimet e reja miratohen nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve².

Studimi, projektimi dhe zbatimi i punimeve në qendrën historike të fshatit dhe monumente të veçanta.

▪ Projektet e restaurimit dhe restaurimi i monumenteve të kulturës bëhen nga institucione shtetërore të specializuara dhe nga subjekte të licencuara për këtë qëllim.

▪ Zbatimi i punimeve të mësipërme kryhet nga Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Vlorë ose nga subjekte të licencuara për restaurim, nën mbikëqyrjen e supervizorit dhe kolaudatorit, caktuar nga Instituti i Monumenteve të Kulturës.

▪ Studimet dhe projektet e rikonstruksioneve, të rrjeteve rrugore apo ndërhyrjeve të tjera publike hartohen nga Instituti i Monumenteve të Kulturës, Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Vlorë ose nga subjekte të licencuar në fushën e restaurimeve për këtë kategori projektesh².

Shfrytëzimi i monumenteve

▪ Monumentet e kulturës janë pjesë e jetës bashkëkohore. Ato shfrytëzohen, sipas rastit, për funksionet për të cilat janë ndërtuar apo edhe për funksione të tjera, me kusht që këto funksione të mos cenojnë vlerat, për të cilat monumenti është vënë në mbrojtje.

▪ Shfrytëzimi i monumenteve të kulturës, për funksione të ndryshme prej atyre për të cilat janë ngritur, bëhet vetëm pasi të jetë marrë miratimi i Këshilli Kombëtar të Restaurimeve².



4.4 Si të marrësh leje

- Nëse banesa juaj është monument kulture apo e ndodhur në një nga qendrat historike, ndiqni rastin A dhe më pas rastin B.
- Nëse banesa juaj nuk është monument kulture apo nuk ndodhet në një nga qendrat historike, kaloni direkt në rastin B.

Rasti A: Qendrat historike dhe monumentet e kulturës

Në Qendrat Historike dhe në rastet e ndërtesave Monumente kulture (qoftë kjo kategoria parë apo e dytë) procedurat e marrjes së lejes kalojnë në dy faza:

- Hapi i parë është marrja e lejes në Institutin e Monumenteve të Kulturës. Për këtë, ju duhet të dorëzoni listën e plotë të dokumenteve në Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare (DRKK Vlorë). Pasi këto dokumente inspektohen nga DRKK, ato i dërgohen Institutit të Monumenteve të Kulturës, kalojnë për miratim në Sekretariatin Teknik Shkencor e më pas në Këshillin Kombëtar të Restaurimit. Vetëm pas marrjes së miratimit nga Instituti i Monumenteve të Kulturës ju mund të vazhdoni me proceset e tjera dhe të aplikoni për leje në Bashki (lista e dokumenteve mund të gjendet më poshtë).
- Pas plotësimit të hapit të parë, procedura vazhdon me aplikimin për leje në bashki.


Në rastet e banesave monument kulture apo brenda qendrave historike, përpara nisjes së procedurave të aplikimit, këshillohet të konsultoheni me zyrat e Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare në Vlorë. Atje mund të gjeni gjithë informacionin e nevojshëm, për sa i përket procedurave të aplikimit.

Projekti duhet hartuar nga një arkitekt me licensë në punë restauratore.

Projekti duhet të ndjekë rregullat dhe udhëzimet e parashikuara në Kartën shqiptare të restaurimit, ligjit "Për Trashëgiminë kulturore dhe muzetë" si dhe vendimet e Këshillit të Ministrave "Për shpalljen e Qendrave Historike".

Dokumentet e duhura për aplikim në DRKK dhe IMK:

1. Projekti i depozituar duhet të jetë në tri kopje dhe me firmë origjinale të hartuesit.
2. Relacioni teknik. - të përshkruajë një historik të shkurtër të objektit, statusit të tij, vendndodhjen, ndërhyrjet e mëparshme (nëse ka). gjendjen aktuale si dhe të gjitha ndërhyrjet që parashikohen të realizohen në projekt. Materiali duhet të shoqërohet me foto ilustruese dhe të mbajë firmën dhe vulën origjinale të projektuesit.
3. Specifikimet teknike: të përshkruhen të gjitha ndërhyrjet dhe materialet që do të aplikohen në ndërhyrje me firmën e vulën e projektuesit.
4. Relacionin e llogarive konstruktive: nëse objekti ka qëndrueshmëri ose në rastet e llogaritjeve të çatave apo elementeve të ndryshëm që kanë lidhje me projektin. Relacioni të shoqërohet me firmë dhe vulë të projektuesit.
5. Preventivi i punimeve; me të gjitha zërat të parashikuara në projekt dhe çmimet përkatëse. Preventivi të jetë me firmë origjinale dhe vulë të projektuesit.
6. Materiali grafik: në fletët grafike të projektit të pasqyrohet sa më qartë: vendndodhja e objektit në *Google Earth* dhe hartën e zonifikimit, foto të gjendjes ekzistuese, vizatimet e gjendjes ekzistuese, të ndërhyrjes si dhe gjendja pas ndërhyrjes. Vizatimet të përmbajnë plane, prerje, detaje dhe të jenë firmosura nga projektuesi.
7. Një CD ku të jetë i hedhur i tërë projekti në format *PDF* ose *Autocad*.
8. Prezantim në *Power Point* për në Këshillin Kombëtar të Restaurimit.






Banesat në Bashkinë Himarë të cilat kanë status mbrojtjeje si Monument Kulture:

Në Bashkinë Himarë nuk ka banesa Monument Kulture të Kategorisë II

Dhërmi	Vuno	Himarë Fshat	Qeparo Fshat	Ilias
Banesa e Strati Zhupës	Rrënojat e banesës së Odise Kasnecit	Banesa e Thano Jorgji Goro	Banesa e Minella Gjickës	Banesa e Lluk Gjidedes
Banesa e Lluk Petro Zhupës	Shtëpia muze e vëllezërve Nushi	Banesa e Lilo Llazarit	Kulla e Ali Pashës	
Kulla e Kumive	Banesa me kullë (rrënojë) e Shane Kokës			
Kulla e Vretos	Kulla Vongli			
Tavani dekorativ në banesën e Pirro Gjipopullit				
Banesa e Petro Markos				

Rasti A: Qendrat Historike dhe Monumentet e Kulturës





4.3 Si të marrësh leje

Rasti B: Aplikimi në Bashki

Nëse banesa juaj nuk është Monument kulture apo nuk ndodhet në një nga qendrat historike, ju duhet të aplikoni vetëm për leje në Bashki.

Ekzistojnë tri lloje ndërhyrjesh që mund të bëni në banesat tradicionale:

- 1** Ndërhyrje që nuk kanë nevojë për leje;
- 2** Ndërhyrje me deklaratë paraprake;
- 3** Ndërhyrje me leje rikonstruksioni (ndërtimi).

Cila procedurë i përshtatet ndërhyrjes që doni të bëni?

1 Ndërhyrje që nuk kanë nevojë për deklaratë paraprake apo leje rikonstruksioni

- Ndërhyrje të jashtme për riparimin dhe zëvendësimin e rifiniturave të jashtme të ndërtesave, me kusht që të ruhen karakteristikat origjinale të tyre;
- Rifreskimi i lyerjes, suvatimit dhe veshjes së fasadave me materiale që kanë karakteristika dhe ngjyra të njëjta me ato ekzistuese;
- Pastrimi i fasadave;
- Riparimi dhe zëvendësimi i dritareve dhe dyerve, qepenave dhe vitrinave (duke përfshirë përdorimin e materialeve të ndryshme), pa ndryshuar karakteristikat e tilla si, forma, ngjyra, dizajni dhe përmasat e pjesëve të hapura dhe transparente;
- Zëvendësimi i pjesshëm i mbulesës së çatisë, pa ndonjë ndryshim të formës, pjerrësisë dhe karakteristikave të veshjes;
- Riparimi dhe zëvendësimi i ulluqeve e oxhakëve, edhe me materiale të ndryshme;
- Riparimi i ballkoneve, tarracave dhe basamakëve apo barrierave mbrojtëse;
- Vendosja e hekurave mbrojtës në dritare;
- Vendosja e tendave të diellit dhe rrjetave kundër mushkonjave;
- Sistemimi i oborreve;
- Riparimi i rrethimeve ekzistuese;
- Riparimi dhe rinovimi i dysHEMEVE;
- Riparimi dhe restaurimi i suvasë, veshjeve dhe ngjyrave;
- Riparimi dhe rinovimi i dyerve dhe dritareve, përfshirë vendosjen e xhamave;
- Ndërhyrje në impiante higjieno-sanitare;
- Veprat e riparimit dhe zëvendësimit të pajisjeve higjieno-sanitare dhe riparimet e impiantit;
- Punimet për heqjen e barrierave arkitektonike dhe përshtatjen e ndërtesave për personat me aftësi të kufizuara;
- Lëvizjet e dheut që lidhen, në mënyrë të posaçme, me ushtrimin e veprimtarisë bujqësore ose blegtorale, përfshirë ndërhyrjet në impiante hidraulike bujqësore;

Nëse ndërhyrja që doni të bëni nuk ndodhet në këtë listë, ju lutem kontaktoni Bashkinë Himarë.

Rasti B: Aplikimi në Bashki

2 Ndërhyrjet që kanë nevojë për deklaratë paraprake

- Ndërhyrjet e mirëmbajtjes së zakonshme kur sjellin ndryshime të karakteristikave, formave dhe ngjyrave ekzistuese;
- Vendosja e shtresave për rritjen e efikasitetit energjetic të ndërtesave ekzistuese.
- Punime të brendshme, si:
 - përforcimi i strukturave mbajtëse të brendshme;
 - hapja dhe mbyllja e dyerve të brendshme;
- Krijimi, heqja ose ndryshimi i mureve ndarës (jo-mbajtës) të brendshëm, i mjediseve për shërbime higjienike;
- Realizimi i impianteve të reja higjieno-sanitare dhe të ngrohjes/ftohjes;
- Punimet për ndërtimin e rampave për përshtatjen e ndërtesave për personat me aftësi të kufizuara;
- Struktura që instalohen për nevoja të çastit dhe të përkohshme, pa themele, me materiale të çmontueshme, pa përdorur struktura beton-armeje, blloqe betoni, muraturë e soleta dhe që hiqen në çdo rast, brenda një afati kohor maksimal 6-mujor;
- Vendosja e paneleve diellore, fotovoltaike, në shërbim të ndërtesave, në përputhje me rregulloren arkitektonike të qytetit dhe kufizimet që mund të rrjedhin nga legjislacioni për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, historike apo mjedisore;
- Punime riparimi, zëvendësimi dhe mirëmbajtjeje të rrjeteve të infrastrukturës publike dhe komunikimeve elektronike, që nuk prekin sistemin konstruktiv të tyre, nuk ndryshojnë përdorimin dhe përmasat e infrastrukturës, si dhe kushtet e zhvillimit në zonën përreth;
- Punime riparimi, mirëmbajtjeje dhe rehabilitimi të infrastrukturës së ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmytja;
- Vendosja e tendave të diellit dhe pergolateve, në përputhje me ligjin që rregullon bashkë-pronësinë në ndërtesat e banimit dhe rregulloren arkitektonike të qytetit;
- Ndërhyrjet me qëllim ruajtjen apo rritjen e efikasitetit energjetik dhe akustik në një strukturë ekzistuese, që nuk prekin sistemin konstruktiv të ndërtesës (p.sh.: ndërhyrje në themele, mure mbajtëse, tra-kolonë etj.);
- Serra të çmontueshme, pa themele të vazhduara, në shërbim të aktiviteteve bujqësore;
- Vendosja e reklamave në fasadat e jashtme, për qëllime të promovimit të aktivitetit ekonomik privat. Vendosja e tyre rregullohet sipas rregullores specifike të secilit autoritet vendor të zhvillimit të territorit;

Nëse ndërhyrja që doni të bëni nuk ndodhet në këtë listë, ju lutem kontaktoni Bashkinë Himarë.



4.3 Si të marrësh leje

Rasti B: Aplikimi në Bashki

3 Ndërhyrje që kërkojnë leje rikonstruksioni (ndërtimi)

- Ndërhyrje që rezultojnë në krijimin e ndërtimeve e reja, përfshirë ato të përkohshme, me përjashtim të rasteve të parashikuara në këtë rregullore;
- Ndërhyrje që rezultojnë në rikonstruksion, riparim dhe restaurim që çojnë në krijimin e një strukture tërësisht ose pjesërisht të ndryshme nga ajo e mëparshme dhe që kanë si pasojë shtimin e njësive dhe/ose ndryshimin e vëllimit ndërtimor, sipërfaqes së ndërtimit, pamjes së jashtme të objektit, të përdorimit ose të sistemit konstruktiv;
- Ndërhyrje që realizojnë mirëmbajtje të jashtëzakonshme sipas kësaj rregulloreje, të shoqëruar me ndryshime të sistemit konstruktiv të objektit;

Rasti B: Aplikimi në Bashki

Çfarë dokumentesh duhet të dorëzoj për secilën ndërhyrje?

Dokumentacioni që duhet plotësuar për pajisjen me deklaratë punimesh:

1. Aplikuesi duhet të jetë i pajisur me prokurë nga zhvilluesi.
2. Deklaratë noteriale nga pronari/bashkëpronari i pasurisë për llojin e punimeve që do të kryejë.
3. Certifikatë pronësie ose vërtetimi hipotekor i pronës, bashkëlidhur harta treguese dhe kopja e kartelës shoqëruese, lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, kopje origjinale, e marrë në tre muajt e fundit. Nëse nuk keni tituj pronësie, një certifikatë nga Bashkia dhe kryetari i fshatit që vërteton se ju jeni pronari i banesës mund gjithashtu të pranohet.
4. Projekti teknik i realizimit të punimeve:
Bashkëlidhur projektit teknik (i cili përmban planimetri të gjendjes ekzistuese dhe planimetri të ndërhyrjeve):
 - Relacioni teknik i projektuesit i nënshkruar.
 - Licensa individuale e projektuesit me kategoritë përkatëse për punimet që do të kryhen, brenda afatit të vlefshmërisë.

Rasti B: Aplikimi në Bashki

Dokumentet që duhen dorëzuar për pajisje me leje rikonstruksioni

Në rast se ju nuk keni certifikatë pronësie, një vërtetim nga bashkia dhe kryetari i fshatit që konfirmon se ju jeni pronari i banesës mund të pranohet gjithashtu.

Për më shumë informacion, ju lutemi të kontaktoni kryetarin e fshatit ose bashkinë Himarë.

1. Formati i aplikimit i nënshkruar.
2. Prokurë për autorizimin e aplikuesit.
3. Certifikatë pronësie ose vërtetimi hipotekor i pronës, bashkëlidhur harta treguese dhe kopja e kartelës shoqëruese, lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (në rast se ju nuk keni certifikatë pronësie, një vërtetim nga bashkia dhe kryetari i fshatit që konfirmon se ju jeni pronari i banesës është po ashtu e pranueshme).
4. Kontratë sipërmarrje, e lidhur midis zhvilluesit, pronarëve të truallit (apo përfaqësuesit të tyre me prokurë) dhe subjektit ndërtues që do të kryejë punimet, e cila duhet të jetë origjinale dhe e lidhur para noterit.
5. Licenca e subjektit ndërtues, me kategoritë përkatëse të punimeve që do të kryhen, brenda afatit të vlefshmërisë. Subjekti duhet të jetë i regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.
6. Vërtetim nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, që subjekti ndërtues ka shlyer taksat dhe tarifat vendore, të parashikuara nga pushteti vendor.
7. Rilevimi topografik në shkallë 1:2000, me kuota sipas relievit.
8. Planimetria e ndërtësës në 1:500 (me firmë të një topografi me licensë).
9. Grafiku i kohëzgjatjes së realizimit të punimeve.
10. Preventivi i realizimit të punimeve i hartuar mbi bazën e çmimeve mesatare, të përcaktuara në aktet ligjore në fuqi.
11. Vërtetim nga OSHEE që subjekti dhe zhvilluesi nuk ka detyrime të papaguara.
12. Projekti arkitektonik:
 - Relacioni teknik i arkitektit, ku përfshihet tabela e të dhënave teknike.
 - Licenca individuale e arkitektit me kategoritë përkatëse të punimeve që do të kryhen, brenda afatit të vlefshmërisë. Projektuesi duhet të jetë i regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.
 - Deklaratë e nënshkruar e arkitektit, me anë të cilës nën përgjegjësinë e tij profesionale, deklaron se e ka hartuar këtë projekt, konform të gjithë standardeve dhe normave teknike në fuqi.
 - Kopje e policës së sigurimit të projektuesit, për mbulimin e përgjegjësisë profesionale.
13. Projekti konstruktiv i strukturës:
 - Relacioni teknik shpjegues dhe llogaritjet përkatëse.
 - Licenca individuale e inxhinierit konstruktor me kategoritë përkatëse të punimeve që do të kryhen, brenda afatit të vlefshmërisë. Projektuesi duhet të jetë i regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.
 - Deklaratë e nënshkruar e inxhinierit konstruktor, me anë të cilës nën përgjegjësinë e tij profesionale, deklaron se e ka hartuar këtë projekt, konform të gjitha standardeve dhe normave teknike në fuqi.
 - Kopje e policës së sigurimit të projektuesit, për mbulimin e përgjegjësisë profesionale.
14. Projekti hidrosanitar i strukturës:
 - Relacioni teknik shpjegues dhe llogaritjet përkatëse.
 - Licenca individuale e inxhinierit konstruktor me kategoritë përkatëse të punimeve që do të kryhen, brenda afatit të vlefshmërisë. Projektuesi duhet të jetë i regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.
 - Deklaratë e nënshkruar e inxhinierit konstruktor, me anë të cilës nën



4.3 Si të marrësh leje

përgjegjësinë e tij profesionale, deklarën se e ka hartuar këtë projekt, konform të gjitha standardeve dhe normave teknike në fuqi.

- Kopje e policës së sigurimit të projektuesit, për mbulimin e përgjegjësisë profesionale.

15.Projekti elektrik i strukturës:

- Relacioni teknik shpjegues dhe llogaritjet përkatëse.
- Licenca individuale e inxhinierit konstruktor me kategoritë përkatëse të punimeve që do të kryhen, brenda afatit të vlefshmërisë. Projektuesi duhet të jetë i regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.
- Deklaratë e nënshkruar e inxhinierit konstruktor, me anë të cilës nën përgjegjësinë e tij profesionale, deklarën se e ka hartuar këtë projekt, konform të gjitha standardeve dhe normave teknike në fuqi.
- Kopje e policës së sigurimit të projektuesit, për mbulimin e përgjegjësisë profesionale.

16.Projekti i ngrohje-ventilimit të strukturës:

- Relacioni teknik shpjegues dhe llogaritjet përkatëse.
- Licenca individuale e inxhinierit konstruktor me kategoritë përkatëse të punimeve që do të kryhen, brenda afatit të vlefshmërisë. Projektuesi duhet të jetë i regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.
- Deklaratë e nënshkruar e inxhinierit konstruktor, me anë të cilës nën përgjegjësinë e tij profesionale, deklarën se e ka hartuar këtë projekt, konform të gjitha standardeve dhe normave teknike në fuqi.
- Kopje e policës së sigurimit të projektuesit, për mbulimin e përgjegjësisë profesionale.

17.Projekti i mbrojtjes kundër zjarrit të strukturës i miratuar nga Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi (PMNZSH), (i vulosur).

- Relacioni teknik shpjegues dhe llogaritjet përkatëse.
- Licenca individuale e inxhinierit konstruktor me kategoritë përkatëse të punimeve që do të kryhen, brenda afatit të vlefshmërisë. Projektuesi duhet të jetë i regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.
- Deklaratë e nënshkruar e inxhinierit konstruktor, me anë të cilës nën përgjegjësinë e tij profesionale, deklarën se e ka hartuar këtë projekt, konform të gjitha standardeve dhe normave teknike në fuqi.
- Kopje e policës së sigurimit të projektuesit, për mbulimin e përgjegjësisë profesionale.


18.Oponenca teknike për projektet e ndërtimit, për të gjitha llojet e punimeve, me vlerë të preventivuar së paku 100 000 000 (njëqind milionë) lekë, e kryer nga Instituti i Ndërtimit.

19.Vërtetim për pagesën e tarifës së aplikimit.

20.Vërtetim për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë.



Rasti B: Aplikimi në Bashki





4.4 Kontakte të dobishme

Lista e arkitektëve të pajisur me licensë në punë restauratore

*Bazuar në të dhëna nga Instituti i Monumenteve të Kulturës, të përditësuara më 23 prill 2018.

A* - LICENSA I PERMBAN TE GJITHA PIKAT A/1;A/2;A/3;A/4 PROJEKTIM -ZBATIM

"AP. Projektim në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës"

"AP/1. Projektim në konservimin e restaurimin e rrënojave arkeologjike";

"AP/2. Projektim në restaurimin e monumenteve të arkitekturës antiko – mesjetare, (nuk përfshihen në këtë pikë monumentet e përmendura në pikat AP/3, AP/4);

"AP/3. Projektim në restaurimin e ndërtimeve civile, monumente të kategorisë së parë dhe të dytë";

"AP/4. Projektim në restaurimin dhe rikualifikimin e qendrave historike".

AZ. Zbatim në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturë"

"AZ/1. Zbatim në konservimin e restaurimin e rrënojave arkeologjike";

"AZ/2. Zbatim në restaurimin e monumenteve të arkitekturës antiko – mesjetare, (nuk përfshihen në këtë pikë monumentet e përmendura në pikat AP/3, AP/4);

"AZ/3. Zbatim në restaurimin e ndërtimeve civile, monumente të kategorisë së parë dhe të dytë";

"AZ/4. Zbatim në restaurimin dhe rikualifikimin e qendrave historike".

"B. Projektim e zbatim në restaurimin e veprave të artit dhe objekteve muzeale"

B/1. Projektim dhe zbatim në restaurimin e mozaikëve;

B/2. Projektim dhe zbatim në restaurimin e afreskeve;

B/3. Projektim dhe zbatim në restaurimin e veprave të artit në dru.

NR	DREJTUESI TEKNIK	LICENSE	KATEGORIA	Lloji i licenses	ADRESA	TEL.
1	Jorgo Jani Xuhano	R.P. 11	KAT A* (A/1;A/2;A/3;A/4)	PROJEKTIM -ZBATIM	Gjirokaster	0692090049
2	Gentian Petraq Stratobërdha	R.P. 12	KAT A* (A/1;A/2;A/3;A/4)	PROJEKTIM -ZBATIM	Tirane	069 2083562
3	Uljam Thanasi Çikopano	R.P. 13	KAT B *	PROJEKTIM -ZBATIM	Tirane	-
4	Hasan Mustafa Nallbani	R.P. 15	KAT B/2	PROJEKTIM -ZBATIM	Tirane	-
5	Hasan Mustafa Nallbani	R.P. 15/1	KAT B/1,B/3	PROJEKTIM -ZBATIM	Tirane	-
6	Spiro Zoi Laçka	R.P. 13	KAT B	PROJEKTIM -ZBATIM	Tirane	0692946754
7	Florenc Ruzhdi Sharka	R.P. 17	KAT A* (A/1;A/2;A/3;A/4)	PROJEKTIM -ZBATIM	Tirane	0682075359
8	Lida Fabian Miraj	R.P. 18	KAT A* (A/1;A/2;A/3;A/4)	PROJEKTIM -ZBATIM	Durres	0662031891
9	Agron Haxhi Doraci	R.P. 19	KAT A* (A/1;A/2;A/3;A/4)	PROJEKTIM -ZBATIM	Gjirokaster	0697300807
10	Aleko Ilo Papakozma	R.P. 20	A/2;A/3;A/4	PROJEKTIM -ZBATIM	Korce	0692065432
11	Veli Hivzi Shehu	R.P. 22	A/2;A/3;A/4	PROJEKTIM -ZBATIM	Tirane	04 22 74778
12	Adelina Vasil Baballëku	R.P. 23	A/2;A/3;A/4	PROJEKTIM -ZBATIM	Berat	0692029050
13	Sokrat Thellor Kuvarati	R.P. 24	B/2;B/3	PROJEKTIM -ZBATIM	Gjirokaster	-
14	Mantho Thoma Bozhori	R.P. 24	B/2;B/3	PROJEKTIM -ZBATIM	Gjirokaster	-
15	Romen Myqerem Çeçi	R.P. 26	A/2;A/3;A/4	PROJEKTIM -ZBATIM	Vlore	0672343371
16	Genc Vasfi Samimi	R.P. 27	A/2;A/3;A/4	PROJEKTIM -ZBATIM	Tirane	0692054802
17	Arben Nazmi Biçoku	R.P. 28	A/2;A/3;A/4	PROJEKTIM -ZBATIM	Tirane	0682023589



18	Sotir Spiro Kosta	R.P. 29	B/3	PROJEKTIM -ZBATIM	Tirane	0693965170
19	Valter Veli Shtylla	R.P. 30	A/1;A/2;A/3;A/4	PROJEKTIM -ZBATIM	Tirane	-
20	Reshat Sami Gega	R.P. 31	A/1;A/2;A/3;A/4	PROJEKTIM -ZBATIM	Tirane	0695195814
21	Shpresa Mihal Prifti	R.P. 32	A/2;A/3;A/4	PROJEKTIM -ZBATIM	Tirane	0682320457
22	Skender Neki Bejko	R.P. 33	A/2;A/3;A/4	PROJEKTIM -ZBATIM	Tirane	0692071315
23	Florian Kristo Denek	R.P. 34	A/2;A/3;A/4	PROJEKTIM -ZBATIM	Sarande	-
24	Sulejman Isuf Dashi	R.P. 35	A/1;A/2;A/3;A/4	PROJEKTIM -ZBATIM	Tirane	0682072974
25	Genci Riza Bregu	R.P. 36	A/2;A/3;A/4	PROJEKTIM -ZBATIM	Korce	0694097123
26	Gligor Stefan Marto	R.P. 38	A/1;A/2;A/3;A/4	PROJEKTIM -ZBATIM	Sarande	0692862099
27	Kozeta Toli Angjeliu	R.P. 37	A/1;A/2;A/3;A/4	PROJEKTIM -ZBATIM	Tirane	0692273370
28	Hekuran Safet Halili	R.P. 39	A/1;A/2;A/3;A/4	PROJEKTIM -ZBATIM	Sarande	-
29	Pirro Thoma Thomo	R.P. 40	A/1;A/2;A/3;A/4	PROJEKTIM -ZBATIM	Tirane	0672343371
30	Gjerak Mazllem Karaiskaj	R.P. 41	A/1;A/2;A/3;A/4	PROJEKTIM -ZBATIM	Tirane	0692070172
31	Gjergj Kristo Frashëri	R.P. 42	A/1;A/2;A/3;A/4	PROJEKTIM -ZBATIM	Tirane	
32	Kliti Miço Kallamata	R.P. 43	A/1;A/2;A/3;A/4	PROJEKTIM -ZBATIM	Korce	0692147022
33	Albert Stefan Plumbi	R.P. 44	B/3	PROJEKTIM -ZBATIM	Korce	-
34	Mustafa Muhamed Arapi	R.P. 45	B/3	PROJEKTIM -ZBATIM	Tirane	0682148893
35	Daniel Dhimitër Gjoni	R.P. 46	A/3;A/4	PROJEKTIM -ZBATIM	Tirane	-
36	Florian Faslli Nepravishta	R.P. 47	A/3;A/4	PROJEKTIM -ZBATIM	Tirane	0682071811
37	Elena Sokrat Mamani	R.P. 48	A/3;A/4	PROJEKTIM -ZBATIM	Gjirokaster	-
38	Alban Romeo Efthimi	R.P. 49	A/1;A/2;A/3;A/4	PROJEKTIM -ZBATIM	Tirane	-
39	Maksim Pipi Mitrojorgji	R.P. 50	A/3;A/4	PROJEKTIM -ZBATIM	Tirane	0699829505
40	Luçjano Theollor Bojaxhiu	R.P. 51	A/1;A/2;A/3;A/4	PROJEKTIM -ZBATIM	Tirane	0692947707
41	Zaim Xhevat Lila	R.P. 52	A/1;A/2;A/3;A/4	PROJEKTIM -ZBATIM	Tirane	0682249108
42	Eda Vladimir Trebicka	R.P. 53	AP/3, AP/4	PROJEKTIM	Tirane	0694035333
43	Eda Vladimir Trebicka	R.P. 54	AZ/3, AZ/4	ZBATIM	Tirane	0694035333
44	Frida Kujtim Pashako	R.P. 55	AP/3, AP/4	PROJEKTIM	Tirane	0693720218
45	Adrian Enver Kalamishi	R.P. 56	AZ/2,AZ/3, AZ/4	ZBATIM	Shkoder	-
46	Fatjon Përparim Saliu	R.P. 57	AP/3, AP/4	PROJEKTIM	Vlore	0692293461
47	Fatjon Përparim Saliu	R.P. 58	AZ/3, AZ/4	ZBATIM	Vlore	0692293461



4.4 Kontakte të dobishme

48	Dhimiter Nikolla Kondakçi	R.P. 59	AP/2,AP/3, AP/4	PROJEKTIM	Korce	-
49	Dhimiter Nikolla Kondakçi	R.P. 60	AZ/2,AZ/3, AZ/4	ZBATIM	Korce	-
50	Klejdi Naim Mlloja	R.P. 61	AZ/3	ZBATIM	Korce	-
51	Alfred Moisi Çomo	R.P.62	AP/2	PROJEKTIM	Tirane	0682074215
52	Alfred Moisi Çomo	R.P.63	AZ/1;AZ/2;AZ/3;AZ/4	ZBATIM	Tirane	0682074215
53	Odhise Taço Zoto	R.P.64	AP/2; AP/3	PROJEKTIM	Tirane	-
54	Olta Luan Kore	R.P.65	B/1;B/2;B/3	PROJEKTIM-ZBATIM	Tirane	-
55	Ervin Tomi Panidha	R.P.66	AP/1AP/2,AP/3, AP/4	PROJEKTIM	Tirane	0692090009
56	Ervin Tomi Panidha	R.P.67	AZ/2, AZ/3	ZBATIM	Tirane	0692090009
57	Florenc Milo Gjikutria	R.P.68	AZ/2, AZ/3	ZBATIM	Tirane	-
58	Pellajia Dhimitri Basha	R.P.69	AZ/1,AZ/2, AZ/3, AZ/4	ZBATIM	Tirane	0692092152
59	Adrian Isuf Çene	R.P.70	B/2 B/3 projektim zbatim	PROJEKTIM-ZBATIM	Tirane	0682120757
60	Bledar Malo Mane	R.P.72	AZ/1,AZ/2, AZ/3, AZ/4	ZBATIM	Tirane	0694337232
61	Genc Vasfi Samimi	R.P.73/74	AP/1 dhe AZ/1	PROJEKTIM-ZBATIM	Tirane	0692054802
62	Genc Hajdari	R.P.74	B/1 B/2 projektim zbatim	PROJEKTIM-ZBATIM	Tirane	-
63	Zamir Ibrahim Marika	R.P.75	B/2, B/3, Projektim e Zbatim	PROJEKTIM-ZBATIM	Tirane	0672058878
64	Enkelejda Sali Murtaj(Alla)	R.P.84	AP/1, AP/2, AP/3, AP/4	PROJEKTIM	Tirane	0674019246
65	Mario Raqi Tashi	R.P.76/ 77	AP/1, AP/2, AP/3, AP/4 ; AZ/1,AZ/2, AZ/3, AZ/4	PROJEKTIM -ZBATIM	Tirane	0699338855
66	Ogri Bujar Mane	R.P.78/79	AP/1, AP/2, AP/3, AP/4 ; AZ/1,AZ/2, AZ/3, AZ/4	PROJEKTIM-ZBATIM	Tirane	0674080966
67	Daniel Hajri Pirushi	R.P.80/81	AP/1, AP/2, AP/3, AP/4 ; AZ/1,AZ/2, AZ/3, AZ/4	PROJEKTIM-ZBATIM	Tirane	0682094523
68	Liri Petrit Shehaj	R.P.82/83	AP/1, AP/2, AP/3, AP/4 ; AZ/1,AZ/2, AZ/3, AZ/4	PROJEKTIM-ZBATIM	Tirane	0684025620
69	Odhise Taço Zoto	R.P.85/86	AP/1, AP/4 ; AZ/1, AZ/2, AZ/3, AZ/4	PROJEKTIM-ZBATIM	Tirane	-
70	Mirela Anastas Mecollari (Jano)	R.P.87/88	AP/1, AP/2, AP/3, AP/4 ; AZ/1,AZ/2, AZ/3, AZ/4	PROJEKTIM-ZBATIM	Tirane	0682088097
71	Arben Petrit Spaho	R.P.89/90	AP/1, AP/2, AP/3, AP/4 ; AZ/1,AZ/2, AZ/3, AZ/4	PROJEKTIM-ZBATIM	Tirane	0692094658
72	Zef Nikoll Çuni	R.P.93/ 94	AP/1, AP/2, AP/3, AP/4 ; AZ/1,AZ/2, AZ/3, AZ/4	PROJEKTIM-ZBATIM	Shkoder	0688058495
73	Neritan Hasan Ceka	R.P.91/ 92	AP/1, AP/2 ; AZ/1,AZ/2	PROJEKTIM-ZBATIM	Tirane	0682366418



Institucione

(që prej 25.06.2018)

▪ Zyrat e DRKK (Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare)

Adresa: Lagjja "Hajro Cakërrri" Rr. "Sulejman Delvina" nr,56, Vlorë, Shqipëri

E-mail: drkkvlore@yahoo.com

Tel: +355 33 30 665

▪ Instituti i Monumenteve të Kulturës

Adresa: Rr. "Aleksandër Moisiu" nr.76, ish-Kinostudio, Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 42455706

Fax: +355 42456169

E-mail: info@imk.gov.al

▪ Bashkia Himarë

Adresa: Spile, Himarë 9425, Vlorë, Shqipëri

Tel: +355 393-2355

E-mail: info@himara.gov.al

Kryetari i Bashkisë: Jorgo Goro

Zv. kryetari i Bashkisë: Ferdinand Dhrami

Drejtori i zyrës së urbanistikës: Gentian Stratobërdha

▪ Kryetarët e fshatrave

Palasë	Odhiese Dhimolea
Dhërmi	Aleks Marko
Ilias	Jorgo Gjomemo
Vuno	Artan Bala
Himara village	Jorgo Goro
Pilur	Jorgo Bala
Kudhës	Niko Jovani
Qeparo	Stefan Kokëdhima
Borsh	Ridvan Hajdini
Qazim Pali	Stavri Boci
Piqeras	Niko Nini
Sasaj	Andi Ahmati
Lukovë	Niqiforo Butci
Shën Vasil	Kico Vlashi
Nivicë	Stefan Llambri

Përditësime

Që prej datës 27.06.2018, me hyren në fuqi të ligjit nr. 27/2018:

“Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, disa terminologji ndryshojnë si më poshtë:

“Instituti i Monumenteve të Kulturës”

- do të quhet-

“Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore”

“Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare”

- do të quhet -

“Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore”

“Këshilli Kombëtar i Restaurimeve”

-do të quhet-

“Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale”

“Monument Kulture”

- do të quhet -

“Pasuri e Paluajtshme Kulturore”

Koordinatorë

Programi: "Zhvillimi i Integruar dhe i Qëndrueshëm i Rajonit Bregdetar Jugor", GIZ Shqipëri
Hans-Jürgen Cassens / Drejtori i Përgjithshëm i GIZ Shqipëri;
Valbona Koçi, Dhurata Gazulli / Koordinatore Programi

Koordinatore për: "Udhëzuesi praktik për mbrojtjen dhe ruajtjen e banesave tradicionale
në fshatrat e bregdetit të Himarës": Valbona Koçi
Eksperte: Iris Gleichmann, Frida Pashako

Autore

Frida Pashako
Iris Gleichmann
Erisa Nesimi (asistente e eksperteve)
Jona Osmani (asistente e eksperteve)

Editimi

Ben Kern (EN)
Iris Gleichmann (EN)
Saemira Pino (AL)
Erisa Nesimi & Eneida Berisha (Përkthim)

Faqosja

Erisa Nesimi
Jona Osmani

Materialet grafike

Jona Osmani
Erisa Nesimi
Mirjana Pali
Arjon Kadillari
Eneida Berisha
Burimi: Arkiva e Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe literatura përkatëse

Fotografia

Armand Habazaj
Erisa Nesimi
Jona Osmani
Joerg Daiber (Spoonfilm Medienproduktion GmbH)

E botuar nga:

Gent Grafik në Korrik 2018
Rr. "Ismet Gusia", Nd. 33, H. 1,
Njësia administrative nr. 1, 1004, Tiranë

GIZ është përgjegjës për përmbajtjen këtij botimi
Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Zyrat e regjistruara

Bonn dhe Eschborn, Gjermani
Programi: "Zhvillimi i Integruar dhe i Qëndrueshëm i Rajonit Bregdetar Jugor"
Rr. Skënderbej 21/1
Tel +355 42 230 414
<https://www.giz.de/en/worldwide/39273.html>

Në emër të:
Ministritë Federale Gjermane për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (BMZ)

Në bashkëpunim me:
Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE)
Ministrinë e Kulturës
Institutin e Monumenteve të Kulturës (IMK)
Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare, Vlorë (DRKK)
Bashkinë Himarë

© Copyright me GIZ, Korrik 2018



Implemented by





Implemented by

giz Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH